



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 10.06.2013
Nr. 0204-734

PËR: Blerim Kuqi, Kryetar i Komunës së Suharekës
Vesel Maliqaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË SUHAREKËS, 01 Nr. 16 - 4053, Pranuar me datë, 07.06.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 Nr. 16 - 4053 të miratuar me datë 31.05.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01 Nr. 16 - 4053, për iniciimin e procedurave për hartimin e planit zhvillimor urban për nën qendrën Studençan- Samadrexhë.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 10.06.2013

br. 0204-734

Za: Blerim Kuqi, Gradonačelnik opštine Suva Reka
Vesel Maliqaj, Predsedavajući Skupštine opštine Suva Reka

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Suva Reka , 01 br. 16 - 4053, primljeno
dana , 07.06.2013

Poštovanj/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01 br. 16 - 4053 odobreno dana 31.05.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .


Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01 br. 16 - 4053, za pokretanje postuaka o izradi urbansitičkog razvojnog plana za pod centar Studenčan- Samadrexhë.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), nenit 17, paragrafi 1, shkronja (b), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, konform nenit 16, të Ligjit, Nr-2003/14, për planifikim hapësinor, dhe dispozitave të udhëzimit administrativ, 02/05, për implementimin e Ligjit për planifikimin hapësinorë, dispozitave kalimtare të PZHK-së, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën 31.05.2013, mori këtë:

V E N D I M

PËR INICIMIN E PROCEDURAVE PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR URBAN PËR NËN QENDRËN STUDENÇAN-SAMADREXHË

Neni 1.

Me këtë vendim lejohet iniciimi i procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Urban për nën qendrën, Studençan-Samadrexhë, me vendbanimet Studençan, Neperbisht, Samadrexhë dhe Doberdelan, sipas kufijve të specifikuar me Plan Zhvillimor Komunal.

Neni 2.

Bazë për hartimin e Planit Zhvillimor Urban për nën qendrën Studençan-Samadrexhë do të jetë Plani Zhvillimor Komunal, planet aktuale detale si dhe gjendja ekzistuese në teren.

Neni 3.

Përcjellëse e procesit të hartimit të planit është Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis e Komunës në Suharekë.

Neni 4.

Bartës për procesin e hartimit të planit është firma kontraktuese e përzgjedhur përmes procedurave të rregullta tenderuese.

Neni 5.

Bartësi i hartimit të planit sipas nenit 4, të këtij vendimi është i obliguar që planin ta hartoj në afat prej 6 muajve nga dita e lidhjes së kontratës për hartimin e tij si dhe dokumentin final ta emërtojë, përpirojë dhe kompletojë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në kohën e sjelljes së dokumentit për miratim në Kuvendin e Komunës në Suharekë.

Neni 6.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), nenit 18, të Rregullores, Nr-01/2013 për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01-Nr- 46-4033
Më datë 31.05.2013

OK



Kryesuesi i Kuvendit

Veseli Maliqaj
Veseli Maliqaj